

VENDIM
Nr. 18, datë 16.3.2015

**PËR SHPËRNDARJEN E FONDIT PËR NËNPROGRAMIN E ARSIMIT, PËR
PROJEKTET NË VAZHDIM, ME CIKËL FINANCIMI 2012-2013**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 e të aneksit 3, të ligjit nr. 160, datë 27.11.2014, "Për buxhetin e vitit 2015", Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Shpërndarjen e fondeve për projekte në vazhdim, me cikël financimi 2012-2013, të nënprogramit të arsimit (arsimi bazë, i mesëm dhe i lartë) pjesë e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2015, sipas tabelës 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen ministri i Arsimit dhe Sportit, ministri i Financave dhe Sekretariati i Përgjithshëm i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, në Kryeministri, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Edi Rama

Zëvendëskryeministri	Zëvendëskryetar;
Ministri i Financave	anëtar;
Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	anëtar;
Ministri i Zhvillimit Urban	anëtar;
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës	anëtar;
Ministri i Arsimit dhe Sportit	anëtar;
Ministri i Shëndetësisë	anëtar;
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe	
Administrimit të Ujërave	anëtar;
Ministri i Kulturës	anëtar;
Ministri i Mjedisit	anëtar;
Ministri i Punëve të Brendshme	anëtar;
Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike	anëtar;
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Komunave të Shqipërisë	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	anëtar;
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore	anëtar.

Tabela 1. Projektet në vazhdim, me cikël financimi 2012-2013

Nr	Autoriteti kontraktues	Emërtimi i projektit	Programi buxhetor	Vlera e kontratës (Lekë)	Vlera faktike e disbursuar deri në fund të vitit 2014 (Lekë)	Vlera e financimit për vitin 2015 (Lekë)
QARKU DIBËR						
1	Komuna Gurrë	Rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare Gurrë e Vogël	9120	14,709,949	12,709,949	1,000,000
2	Komuna Derjan	Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare Dukagjin,	9120	13,000,000	11,198,880	900,000
3	Bashkia Bulqizë	Rikonstruksion i shkollës se mesme Bulqizë	9230	27,595,518	22,316,215	2,500,000
QARKU DURRËS						
4	Komuna Xhafzotaj	Ndërtim i shkollës 9-vjeçare ne fshatin Rreth, Komuna Xhafzotaj	9120	72,000,000	59,395,000	4,000,000
5	Komuna Katundi i Ri (0707)	Ndërtimi i shkollës 9-vjeçare, fshati Sukth, komuna Katund i Ri	9120	83,847,168	42,967,567	13,000,000
6	Universiteti A. Moisiu Durrës	Ndërtimi i një godine të re universitare për Universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës	9450	255,000,000	114,507,425	21,202,456
QARKU ELBASAN						
7	Komuna Polis	Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare Polis, Gur-Shpatë, komuna Polis	9120	16,932,504	9,279,673	3,826,416
8	Komuna Mollas	Ndërtim shk mesme "Osman Gjini", komuna Mollas Elbasan (FZHR)	9230	166,525,202	149,672,897	8,000,000
9	Komuna Bradashesh	Ndërtim shkolle e mesme Bradashesh	9230	164,370,151	90,000,000	35,000,000
QARKU FIER						
10	Komuna Kurjan	Ndërtimi shkollës 9-vjeçare, fshati Ngjeqar, komuna Kurjan	9120	48,443,858	33,780,709	5,000,000
11	Komuna Qendër Mallakastër	Rikonstruksion shk 9-vjeçare, fshati Visoke, komuna Qendër Mallakastër	9120	47,876,474	27,876,743	7,000,000
12	Komuna Ruzhdie	Rikonstruksion shk 9-vjeçare, Ruzhdie	9120	17,268,281	6,909,401	5,000,000
13	Komuna Terbuf (0922)	Rikonstruksion dhe shtesë e shkollës së mesme të bashkuar Çermë Sektor	9230	37,420,000	26,047,363	4,800,000
QARKU KORÇË						
14	Komuna Proptisht , Pogradec	Ndërtim i ri shkolla e mesme e bashkuar Radokal	9230	49,418,641	39,418,641	4,000,000
QARKU KUKËS						
15	Komuna Fajza	Rikonstruksion dhe shtesë shkolle, Vranisht, Komuna Fajzë	9120	47,923,053	42,413,690	2,500,000
QARKU TIRANË						
16	Komuna Berzhite	Ndërtim i shkollës 9-vjeçare, Mihajas, Komuna Berzhitë, FZHR 2012	9120	30,256,068	-	14,000,000
17	Komuna Synej	Ndërtim shkolla 9-vjeçare dhe e mesme "11 Shkurti" Komuna Synej, Kavajë	9120	53,849,928	43,270,991	4,200,000

18	Komuna Dajt	Rikonstrukcion i shkollës së mesme të bashkuar, Surrel	9230	15,320,482	10,599,500	4,000,000
19	Universiteti Politeknik	Shtesa e godinës së Universitetit Politeknik Tiranë (detyrim)	9450	128,041,218	50,000,000	21,071,128
	QARKU SHKODËR					
20	Komuna Qafë - Mali	Rikonstrukcion shkolla 9-vjeçare Kryezi, komuna Qafë - Mali	9120	14,561,026	5,491,000	5,000,000
	TOTAL			1,304,359,521	797,855,644	166,000,000

Shënim:

1. “Vlera e kontratës” përfaqëson vlerën e kontraktuar nga autoriteti kontraktues për zbatimin e punimeve. Vlera e kontratës përcillet nga sekretariati teknik (Ministria e Arsimit dhe Sportit).
2. “Vlera faktike e disbursuar deri në fund të vitit 2014” përfaqëson vlerën e përthithur nga autoriteti kontraktues për zbatimin e projektit. Vlera faktike e disbursuar përcillet nga sekretariati teknik (Ministria e Arsimit dhe Sportit).
3. “Vlera e financimit për vitin 2015” tregon diferencën e vlerës së kontratës me vlerën faktike të disbursuar deri në fund të vitit 2014.
4. Financimi për vitin 2015, shlyen pjesërisht detyrimin për këto projekte, duke mos përmbyllur plotësisht detyrimin financiar për projektet e nënprogramit të arsimit, me cikël financimi 2012-2013.
5. Projektet me autoritet kontraktues komunat zbatohen në përputhje me vendimin e KZHR nr.6, dt.9.2.2015, “Për administrimin “tranzitor” të projekteve me autoritet kontraktues komunat, për periudhën shkurt-shtator 2015”.

